

Sokol Çunga (1980 –) është arkivist në Sektorin e Promovimit dhe të Komunikimit në Drejtorinë e Evidencës Qendrore dhe të Komunikimit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Që prej vitit 2013 është pedagog i jashtëm në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës, ku jep ciklet e leksioneve të *greqishtes bizantine* dhe të *muzeologjisë* (niveli *bachelor*) dhe ato të *ruajtjes dhe mbrojtjes së dokumentit* (niveli *master*). Është diplomuar në: Akademinë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”, Shën Vlash, Durrës (2002); në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Katedra e Gjuhëve Sllavo-Ballkanike, dega e gjuhës greke, Universiteti i Tiranës (bachelor – 2006); në Fakultetin e Historisë, Universiteti i Jonit – Korfuz, Greqi (master – 2016). Që prej vitit 2008, kohë kur filloi të punojë në Arkivin Qendror Shtetëror, është aktiv në promovimin e pasurisë dokumentare të AQSH-së, duke qenë bashkorganizator i ekspozitave të ndryshme me karakter historik e kulturor, si dhe merr pjesë rregullisht në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në fushë të historisë dhe të arkivistikës. Është fitues i çmimit “Kërkuesi i ri më i suksesshëm në shkencat shoqërore dhe albanologjike 2016” dhënë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë për botimin faksimile “Katërungjillëshi i Korçës, Kodiku i Korçës nr. 93” (Athinë, 2012, në bashkautorësi me PhD.C. Andi Rëmbeci).